

SKEDË TEKNIKE

RÖFIX Renoplus®

Suva nivelimi dhe rinovimi universale




Fushat e përdorimit

Suva rinovimi dhe nivelimi universale, me trashësi shtrese nga 3 deri në 30 mm. Për përdorim në ambiente të brendshme dhe jashtëme, në mure dhe tavane prej tullash, betoni si dhe në suva të qëndrueshme ekzistuese, në ndërtesa të reja, në nënshtresa të vjetra pas testimit të ngjitjes dhe në ruajtjen e monumenteve. Mund të përdoret në sipërfaqe të lëmuara të mureve dhe tavaneve minerale (sipërfaqe betoni, tulla rërë-gëlqere, etj.) pa urë ngjitëse. Si mbushës përforcues dhe suva përforcuese me rrjetë përforcuese RÖFIX (P100 ose P50) me mbivendosje 10 cm secila, p.sh. në sipërfaqe të plasaritura, në suva izoluese ose në suva bazë mbi tulla të lehta. Zona të tjera aplikimi, p.sh. si suva me ndjesi të papërpunuar dhe mund të përdoret gjithashtu si suva rustike shtres hollë në sipërfaqe të lagura, për mbulimin e pllakave qeramike në banjot e shtëpive deri në maksimum 1600 cm², si një mbushës ngjitës në sipërfaqe të lëmuara prej betoni ose guri rërë-gëlqere për suva të mëvonshme izoluese dhe/ose gëlqere, si llaç profilizues për suva të imta dhe të trasha, mundësisht direkt në fasada, por edhe për mure të brendshme dhe tavane dhe gjithashtu për përgatitjen paraprake në bazament dërrase, veçanërisht i përshtatshëm për sistemet e ngrohjes në mur - kontakti shërbimin e konsulencës RÖFIX.


Karakteristikat

- ekonomik dhe i përdorshëm në mënyrë universale
- Përpunim i shkëlqyer nga 3 deri në 30 mm
- I armatosur me fibra
- Ngjitje e mirë
- Tkurrije e ulët, SR1
- Rekomandohet veçanërisht për sa i përket jetesës ekologjike

Përpunimi



Të dhëna teknike

Numri i artikullit	19805
EAN	9003304198054
Paketimi	
Sasi për njësi	25 kg/Nj.
Njësi për paletë	48 Nj./Pal
Madhësia e kokrrizave	0-1 mm
Konsumi	rreth. 1,45 kg/m ² /mm
Udhëzime për përdorimin	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese, ato varen shumë nga karakteristikat e bazamentit dhe nga teknika e aplikimit. Kur zhvillohet punimi për herë të parë dhe në raste të aplikimit në sipërfaqe të mëdha këshillohet realizimi paraprakë në një sipërfaqe prove.
Njësia e kërkesës për ujë	rreth. 7,5 L/Nj.

RÖFIX Renoplus®

Suva nivelimi dhe rinovimi universale

Numri i artikullit	19805
Reaksioni ndaj zjarrit	A1
Kapilariteti	$\geq 2 \text{ kg/m}^2 \cdot \text{min} 0,5$
Përshkueshmëria e avujve të ujit	15/35 (Tabela e vlerave)
Hapja e difuzionit të avullit	Përshkueshmëri e lartë
Forca në lidhje	$\geq 0,32 \text{ N/mm}^2$
Përcjellshmëria termike	0,61 W/mK për P=50% EN 1745:2002 (Vlera e tabelës) 0,66 W/mK für P=90% EN 1745:2002 (Vlera e tabelës)
Moduli-E	rreth. 3500 N/mm^2
Trashësia maksimale e shtresës	30 mm
Koha e tharjes	10 d
Grup llaçi	GP EN 998-1 Wc0 EN 998-1 CS II, i përshtatshëm për pllaka (ca. 3 N/mm^2) EN 998-1
Trashësia e shtresës	3-30 mm
Kapaciteti termik	rreth. 1 kJ/kg K
Dëndësia në gjëndje të papërpunuar	rreth. 1400 kg/m^3 rreth. 1300 kg/m^3
Temperatura e nënshtresës	5-25 °C
Këshilla për paketimin	Në thasë letre me mbrojtje kundër lagështisë.

Baza e materialit

- Fibra
- Rërë gëlqereje e imët me cilësi të lartë
- Gëlqere e pashuar
- Përbërës organik < 1,5 %
- Çimento e bardhë (pa kromate)
- Aditivë për përmirësimin e vetive të përpunimit

Kushtet e punimit

Gjatë fazes së përpunimit dhe tharjes, ambienti përreth sikurse dhe temperatura e bazamentit nuk duhet ulet nën +5 °C dhe nuk duhet të ngrihet mbi +30 °C.

Bazamenti

Sipërfaqet duhet të jenë të pastra, të fortë, pa lagështi të përhershme, pa pluhur, të qëndrueshme dhe të pa myke, vajra, graso, dhe të tjerë faktorë ndikues. Testimi i bazamentit duhet të vijojë sipas ÖNORM B3346 ose DIN 18350 ose SIA V242. Pjesë suvaje të dëmtuara eliminohen. Pjesë të lira ose të shkëputura në ndërtesa të vjetra të mbrojtura nga shteti, pastrojnë vetëm duke marrë një miratim nga zyra përkatëse. Nëse këto pjesë nuk do të pastrohen ose zëvendesohen, atëherë duhet të ngjitsn përsëri në mënyrë profesionale.

ROFIX Renoplus®

Suva nivelimi dhe rinovimi universale

Bazamenti-Trajtimi paraprak

Suvatë apo shtresat e bojës pa aftësi mbajtëse duhet të eliminohen.

Përgatitja

Pas përzjerjes lëreni 10 min. në qetësi dhe pastaj përziheni përsëri.

Përpunimi

Në rastin e përdorimit si suva përforcuese me një trashësi afërsisht 3 mm, shtroni në mes rjetën armuese ROFIX P50. Rrjeta armuese duhet të lihet nga çdo anë 10 cm më e gjatë. Në rast përpunimi me dorë, materjalin e perzierë shtojeni me mistiri apo vegël tjetër të përshtatshme. Në aplikimin me makineri sprucojeni me pompën e suvasë. Më pas hiqni me mastar pjesët e tepërta. Suvaja e aplikuar mund të strukturohet edhe direkt në shtresën e fundit me një mallë strukturoese. Nëse ekspozohet ndaj motit të drejtpërdrejtë (shiu, bora), RENOPLUS duhet të mbrohet me masa të përshtatshme mbrojtëse.

Këshilla në rast riziku

Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.

Magaznimi

Magazinojeni në vende të thata mundësisht mbi paleta druri. Mund të ruhet për të paktën 12 muaj. Pa kromat sipas rregullores 1907/2006/EG Aneksi XVII.

Certifikatë



Udhëzime teknike dhe ligjore

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skedat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

Këshilla të përgjithshme

Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme. Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkojnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme. Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në vetevete nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar. Produktet ROFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohej një cilësi e pandryshueshme. Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona. Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (www.roefix.com), ose mund të kërkohen edhe pranë filjaleve rajonale në vënd. Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda. Të gjitha të dhënat teknike të dhëna në këtë fletë produkti janë përcaktuar në kushte laboratorike.